



01. Nr. 64/10
Më: 25 03 2010

PROCESVERBAL
Nga mbledhja e III-të (II-të për v. 2010) e Kuvendit Komunal
në Vushtri mbajtur më 25.2. 2010

Mbledhja u mbajt në sallën e Kuvendit Komunal duke filluar në orën **10:00**. Në këtë mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtri.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe: Bajram Mulaku, kryetar i Komunës, Xhevahire Izmaqi-nënkryetare e Komunës, drejtorët e drejtorive komunale, përfaqësues të OSBE-së, përfaqësues të Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të ICO (Zyra Civile Ndërkombëtare), dhe përfaqësues të mediave të shkruara dhe të shoqërisë civile.

Para fillimit të mbledhjes, u mbajt një minutë heshtje, në shenjë nderimi të jetës dhe veprës së Xhemajl Abazit, ish-këshilltar i Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z. Ferit Idrizi, kryesues i Kuvendit, i cili pasi konstatoi se ka kuorum për punë, propozoi këtë:

R E N D D I T E

- 1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës, mbajtur më 28.01.2010.**
- 2. Informatë për pasqyrat financiare të Komunës për vitin 2009 dhe për të hyrat vetanake për muajin janar 2010.**
- 3. Informatë për suksesin e nxënësëve për gjysmë vjetorin e parë të vitit shkollor 2010.**
- 4. Propozimvendim për plotësimin e rregullorës për tarifa, ngarkesa dhe gjoha komunale.**
- 5. Propozimvendimi për mënyrën e llogaritjes dhe lartësinë e kompensimit për mbikëqyrjen e objekteve – projekteve kapitale.**
- 6. Propozimvendimi për mënyrën e llogaritjes dhe lartësinë e kompensimit për pranimin teknik të objekteve – projekteve kapitale .**
- 7. Propozimskema Organizative e Komunës për vitin 2010.**
- 8. Kërkesa për bartjen e mjeteve të zotuar dhe mjeteve të lira, nga THV të vitit 2008-2009 në vitin 2010.**

9. Propozimi i KPF-së për caktimin e lartësisë së kompensimit për komitetet konsultative.

10. Të ndryshme

a. Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të dy zyrave të Shtëpisë së Kulturës në Prilluzhë;

b. Propozimvendimi për formimin e komisionit për intervistim, për drejtorë të shkollave;

c. Propozimvendimi për formim të komisionit për hartimin e rregullores për përcaktimin e kriterëve të përfituesve material ndërtimor për ndërtim-meremetim të objekteve banesore.

Zeqir Hasani- lidhur me propozimin për dhënien e dy zyrave për OJQ-të në Prilluzhë, kërkoi sqarim se a janë planifikuar mjete për renovimn e atyre zyrave.

Ferit Idrizi- investimi për renovimin e zyrave në fjalë do të bëhet nga vet OJQ-të.

Refik Ramaj- propozoi që pjesa e parë e pikës 2 të rendit të ditës të heqet, me arsyetimin se në mbledhjen e kaluar kur është shqyrtuar raporti i auditorit të pavarur, tha që jemi marrë vesh, dhe është pajtuar edhe Kryetari i Komunës që të na ipet (sillet) një plan i implementimit të rekomandimeve të auditorëve, pasi që nuk ka kuptim të debatohet për pasqyrat financiare 2009, pa pasur plan të veprimit të implementimit të rekomandimeve të auditorit të pavarur. Gjithashtu propozoi që pika 8 dhe 9 të shtyhet. Gjithashtu propozoi që të shtyhet për seancën e ardhshme Plani i Drejtorisë për Prokurim, për implementimin e rekomandimeve të paraqitura në raportin e auditorit të pavarur.

Ismet Gashi- propozoi që propozimvendimi nga Drejtoria e Shëndetësisë nuk ka nevojë të kaloj në Kuvend, pasi që nuk është e nevojshme, pasi që kjo çështje është detyrë e drejtorisë përkatëse. Paraqiti vërejtje për dërgimin e materialit të Kuvendit me vonesë, poashtu paraqiti vërejtje që nuk po zbatohen planet që vet po i miratojmë. Në fund kërkoi që për mbledhjen e radhës, anëtarëve të Kuvendit t'iu sigurohet nga një kopje të planit të punës së Kuvendit për vitin 2010.

Nysret Gërxhaliu- theksoi që për pikat e rendit të ditës që në Kuvend vijnë si informata, nuk ka nevojë për informata të jepen sugjerime.

Muharrem Shabani- e rikujtoi marrëveshjen që e kanë arritur me kryesuesin e Kuvendit dhe me përfaqësuesit e subjekteve tjera politike, duke bërë të ditur që janë dakorduar për rritjen e numrit të anëtarëve të komiteteve obligative, dhe në fund tha që nëse nuk realizohet marrëveshja në fjalë, grupi asambleistë nga AAK-ja do ta shqyrton pjesëmarrjen në këto komitete.

Sabit Kadriu- propozoi që të investohet në pajisje teknike, në mënyrë që të gjithë delegatët të kenë mundësi për t'u shprehur nga karriget e tyre, pa pasur nevojë të dalim tek foltorja. Në vazhdim foli për propozimin e Drejtorisë së Arsimit, duke shtuar se ka qenë mirë që në pikën 3 të rendit të ditës të përfshihet edhe propozimi i Drejtorisë së Arsimit për formimin e komisionit intervistues për zgjedhjen e drejtorëve të shkollave.

Ferit Idrizi- tha që pajtohet që të hiqet pjesa e parë e pikës 2 të rendit të ditës. Sa i përket mjeteve buxhetore, buxheti është aprovuar për vitin 2010, dhe janë projektet, prioritetet i ka caktuar shefi i Qeverisë, buxheti është shfrytëzuar shumë mirë, pak mjete kanë mbetë, ato barten. Në vazhdim u pajtua që të heqet nga debati plani i Drejtorisë për Prokurim Publik për implementim të rekomandimeve të auditorit nga raporti i auditimit. Sa i përket komiteteve konsultative, Kuvendi mund të merr vendim për caktimin e lartësisë së kompensimit, por kompensimi të fillon pas rishikimit të buxhetit. Gjithashtu duhet të përpilohet një rregullore për funksionimin e komiteteve konsultative. Sa i përket vonesës së dërgimit të materialit për seancat e Kuvendit, kjo ka ndodhur kësaj radhe për shkak të festës së Pavarësisë, por një vonesë e tillë e materialit në fjalë, nuk do të përsëritet në të ardhmen. Kurse, sa i

përket pikës së rendit të ditës që ka qenë e planifikuar me planin vjetor të punës së Kuvendit (raporti i Kryetarit të Komunës për situatën ekonomiko-financiare të komunës dhe për zbatimin e planeve investuese të komunës), Kryetari i Komunës nuk e ka përgatit materialin për këtë seancë, por në seancën e radhës do të jetë i gatshëm materiali, dhe do të raporton Kryetari i Komunës para delegatëve. Duke iu përgjigjur pyetjes së M. Shabanit, bëri të ditur që është e vërtetë që kemi arrit një marrëveshje për rritjen e numrit të anëtarëve të komiteteve obligative, por Ligji për Vetëqeverisje Lokale ka me u kthyer në Parlament (gjatë muajit Mars) për aprovim, pastaj Kuvendi i Komunës duhet ta formon komisionin për ndryshimin dhe harmonizimin e Statutit të Komunës me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale. Përndryshe, me këtë përqindje që ka subjekti juaj (AAK-ja) në asamble, nuk i takon më shumë se një anëtarë në komitete, përderisa komitetet përbëhen nga 5 anëtarë.

Në vazhdim, Kuvendi pas votimit, me 27 vota “për”, të tjerët “abstenim”, aprovoi rendin e propozuar të ditës së bashku me propozimin e z. Ramaj, që nga rendi i ditës të hiqet pjesa e parë nga pika nr.2, si dhe plani për implementim të rekomandimeve të auditorit, të paraqitur nga Drejtoria për Prokurim Publik.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës, mbajtur më 28.01.2010.

Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit, njëzëri, aprovoi procesverbalin nga mbledhja e Kuvendit të Komunës, mbajtur me 28.01.2010, pa vërejtje dhe sugjerime.

2. Informatën për të hyrat vetanake për muajin janar 2010.

Isuf Jashari- paraqiti sqarimet hyrëse, me ç’rast informoi që të hyrat e realizuara për muajin janar 2010 janë 58.896 €.

Muharrem Shabani- tha që kjo që kemi (një faqe material për këtë pikë të rendit të ditës) nuk është informatë, por është vetëm një pasqyrë, e cila nuk paraqet diçka konkrete, pasi që nuk janë bërë krahasime të realizimit (të të hyrave) me vitin paraprak. Në vazhdim bëri të ditur që nuk ka elemente tjera as te tatimi në pronë, pasi që dëshirojmë të na informoni që për disa struktura si është pagesa e tatimit, a është i viteve paraprake, a është vetëm i këtij viti (2010), sa është i vitit 2009, sidomos te tatimet në pronë, edhe te tatimet tjera që janë obligative rreth shumë objekteve dhe pronave që janë ndërtuar dhe nuk janë paguar në Komunë. Në fund pyeti për numrin e lejuar të të punësuarëve në institucionet komunale në Vushtri, nëse është numri i lejuar 1544 sipas Ligjit të Buxhetit, kurse në fund të vitit 2009 kemi 1557 punëtorë, pra ka rreth 13 punëtorë më shumë. Në bazë të cilave vendime, në bazë të çkafit bëhen pagesat, në bazë të çkafit bëhen këto shkelje të ligjit, dëshiroj të na sjellni edhe një regjistër me emra; a janë ekspertë apo janë çështje tjera, pasi që mund të jenë më shumë militantë të partisë sesa që janë ekspertë të caktuar.

Besim Jashari- bëri të ditur se kjo Informatë nuk i plotëson pritjet tona, pasi që këtu është paraqitur në kolonë planifikimi mujor i të hyrave për muajin Janar 2010, dhe është bërë krahasimi me të hyrat e muajit Janar 2009. Informata duhet me qenë e plotë dhe complete, në mënyrë që të krijohet një pasqyrë e qartë mbi të hyrat që janë realizuar. Në vazhdim theksoi që në kolonën e planifikimit të vitit 2010, në shumë kategori të të hyrave nuk është përmbushë plani nga ajo që është planifikuar, dhe shihet në shumë kategori që të hyrat në Janar 2010 janë dukshëm më të vogla se në Janar 2009, dhe mori shembull të hyrat nga shfrytëzimi i pronës komunale, pastaj regjistrimin e bizneseve. Në seancën e kaluar kemi pas një informatë në të cilën është thënë që kanë qenë mbi 400 biznese që kanë operuar pa leje pune. Pastaj propozoi që kur të bëhet një Informatë e tillë nga Drejtoria e Thesarit, të bëhet mënyrë analitike, nëse ka pas më shumë të hyra, me treguar si e ka arrit këtë shtim

të të hyrave, e nëse nuk ka mujt me i realizuar siç i ka planifikuar, me na treguar ku janë defektet, ku janë dobësitë. Në fund rikujtoi që tek të hyrat nga shëndetësia primare, 5.000 € janë planifikuar, kurse janë realizuar 3.160 €, pra ka një mosrealizim goxha serioz, dhe kjo flet për një joseriozitet dhe joprofesionalizëm.

Zeqir Hasani- bëri të ditur që bizneset në vazhdimësi nuk po pajisen me leje pune. Në vitin e kaluar 70 % të bizneseve kanë afaruar pa leje pune, poashtu këtë vit të hyrat nga lejet e punës janë zero. Gjithashtu as 10 % të bizneseve nuk janë të ngarkuar me taksë komunale, kurse të gjitha bizneset duhet të ngarkohen me taksë komunale në muajin e dytë. Në çdo aktvendim të taksës komunale ku ngarkohen bizneset, thuhet se pagesa duhet të bëhet në dy këste, kësti i parë deri në muajin e 6-të, kësti i dytë deri në muajin e 12-të. Ndërsa, sa i përket të hyrave të planifikuara dhe të realizuara, thuhet që diku rreth 81.36 % është realizimi, mirëpo në bazë të një raporti nga MAPL-ja thuhet që Komuna e Vushtrisë i ka realizuar të hyrat vetanake 46 %, që është mjaft dobët, më vonë thuhet që ndër komunat që kanë realizuar të hyra vetanake në shkallë më të ulët në Kosovë është edhe Vushtrria, pa i marrë parasysh bartjen prej 501.000 €, që është bërë nga viti i kaluar.

Isuf Jashari- theksoi që vet titulli Informatë paraqet një gjendje faktike tabelare, dhe në çdo fund muaj e informojmë edhe Departamentin e Thesarit lidhur me realizimin e të hyrave, kurse çdo tre muaj paraqesim raportin në mënyrë analitike. Sa i përket planifikimit në vitin 2009 qarkorja buxhetore i përcakton kufijt për grantet, për paga, mallra dhe shërbime, komunalit dhe investime kapitale. Në fund, duke iu referuar asaj që tha Z.Hasani për analizën që e përmendi, theksoi që në atë analizë nuk janë llogaritur të hyrat nga gjykata, nga vendimet e gjyqit, gjobat e komunalive, por aty janë llogaritur vetëm të hyrat e rregullta.

Refik Ramaj- tha që nëse i referohemi raportit të auditorit dhe raportit të thesarit, ka diskrepancë të jashtëzakonshme, dhe mori shembull raportin e të hyrave vetanake, poashtu theksoi që as thesari nuk është në gjendje më të mirë. Në vazhdim tha që planifikimi ka qenë i tmerrshëm, 41.000 € janë planifikuar në vitin 2008, kurse janë realizuar 110.000 €, kjo nuk ka kurrfarë logjike profesionale. Planifikimi nuk është real, dyshoj në saktësinë e të dhënave, ka të hyra të viteve të kaluara. Drejtoria e Thesarit ka tri diskrepanca që flet për të hyra vetanake në shuma të ndryshme.

Tasim Gubetini- bëri të ditur që Informata flet për planifikimin e të hyrave dhe realizimin, por shihet që gjatë muajit Janar nuk është realizuar ajo që është planifikuar, kurse këtu po diskutohet për të hyrat vjetore, për të kaluarën, e shumë pak po debatohet për gjendjen e tanishme. Në fund kërkoi nga Drejtoria e Thesarit arsyen pse nuk është realizuar ajo që është planifikuar, a është mospuna e zyrtarëve që merren me inkasimin e të hyrave, apo mosgatishmëria e qytetarëve që të inkasojnë obligimet që i kanë ndaj komunës.

Bajram Mulaku- bëri të ditur që ka insistuar që Drejtoria e Buxhetit të kryej punën sa më mirë që të krijon të hyra, në mënyrë që të realizojmë projekte. Kjo Informatë të jep mundësi për të kuptuar mjaft, ku të hyrat mund të grumbullohen, dhe ku janë dështimet. Në vazhdim e mori shembull funksionimin e shfrytëzimit të tokës dhe lejet e ndërtimit, me ç'rast janë planifikuar 12.700 €, ndërsa janë realizuar 1.270 €, kjo mund të shqyrtohet pse? Gjithashtu janë planifikuar 2.500 € për pagesën e regjistrimit të pronës dhe transferit, kurse janë realizuar 1.276 €, kërkoi nga drejtori me u përqëndruar më shumë, që me krijuar të hyra më të mëdha. Në fund tha që edhe fushata zgjedhore ka ndikuar që në 6-mujorin e dytë të kemi rënie drastike, në krahasim me 6-mujorin e parë, ndoshta inercioni i asaj fushate ka ndikuar edhe Janar, por në muajin Shkurt është një përmirësim.

3. Informatë për suksesin e nxënësve për gjysmë vjetorin e parë të vitit shkollor 2010.

Vlora Qirezi- tha që kjo nuk është Informatë, por është një pasqyrë tabelare. Në këtë informatë nuk bëhet e ditur se a zhvillohen aktivitete sportive, kulturore dhe gara të ndryshme. Në vazhdim tha që e gëzon fakti për rezultatet (kalueshmërinë) e nxënësve në shkollat fillore dhe në shkollat e arsimit të mesëm të ulët, por është tepër shqetësues kalueshmëria e arsimit të mesëm të lartë, dhe pyeti se si është e mundur të ndryshon kaq shumë sukcesi, a mund të ndodh që në shkollat fillore të mos jetë notimi real? Pastaj bëri të ditur që në shkolla të mesme ka nxënës që nuk din as shkrim dhe as lexim, prandaj i propozoi Drejtorisë së Arsimit që formon një grup prej mësimitdhënësve të cilët do t'i identifikojnë nxënësit në shkolla fillore, që nuk din shkrim dhe lexim, dhe me ta të krijohen klasë të veçanta dhe mësues të caktuar të punojnë me ta. Në fund tha që largimi i shërbimit pedagogjik ka lënë një boshllëk, prandaj grupi asambleistë i LDK-së propozon kthimin e pedagogëve dhe psikologëve, pasi që janë të nevojshëm dhe të domosdoshëm.

Qazim Azemi- tha që informata për suksesin e nxënësve për gjysmëvjetorin e parë (të vitit shkollor 2010) më shumë është si tabelë, por këto tabela u dasht të përcillen me disa komente për sukses apo mosesukses. Poashtu u dasht të kemi Informatë edhe për institucionet parashkollore. Në këtë Informatë u dasht me qenë ndonjë sqarim pse ky sukses kaq i dobët në shkollën e mesme të lartë? Disa nga shkaqet u dasht me u përmend edhe këto: numri i madh i nxënësve në klasë (prej 40 deri në 50 nxënës në një klasë), mbingarkesat e programit mësimor, mungesa e teksteve shkollore për 50 lëndë në shkollat profesionale, mosrealizimi i punës praktike më shumë se 20%. Në vazhdim theksoi që gabimi i madh është që akoma prioritet i jepet gjimnazit, e jo shkollave profesionale të mesme. Poashtu përmendi si gabim tjetër edhe mungesën e të dhënave në Informatë për nxënësit me aftësi të kufizuara, pastaj konstatoi se kjo Informatë është e mangët dhe duhet të plotësohet. Në fund i bëri dy pyetje për Drejtorinë e Arsimit:

1. Për muajin Janar a ka mbetë ndonjë punëtor i arsimit pa u përfshirë në listën e pagave, sa punëtorë janë dhe pse kanë mbetë?
2. Si është bërë riemërimi i ushtruesve të detyrave të drejtorëve në shumë shkolla tona?

Selvetë Sholla- tha që është brengosëse kalueshmëria e nxënësve në shkollat e mesme, me 25%. Poashtu brengosëse është lënia (braktisja) e shkollës nga nxënësit, ku përfshihen 125 nxënës (i bjen 4 paralele), dhe për këtë mungon një arsytim pse ka ardhur deri te kjo? Ndërsa sa i përket suksesit të dobët, tha që ekziston një mungesë e madhe e bashkëpunimit prind-nxënës-mësimdhënës, prandaj kërkoi që në të ardhmen të krijohet një bashkëpunim më i madh i trekëndëshit prind-nxënës-mësimdhënës. Një dukuri shumë negative është mbajtja e kurseve ilegale nga disa mësimdhënës. Në vazhdim pyeti: a nuk duhet të kërkojnë leje këta mësimdhënës për mbajtje të kurseve, a i plotësojnë kushtet elementare ambientet ku i mbajnë ato kurse? Në fund, në emër të grupit asambleistë të LDK-së kërkoi që në seancën e radhës Drejtoria e Arsimit të sjellë një informatë lidhur me atë se sa është numri i mësimdhënësve që mbajnë kurse ilegale.

Islam Krasniqi- tha që është i brengosur për nxënësit e shkollave fillore, pasi që një numër i madh i nxënësve zhvillojnë procesin mësimor në një klasë (mbi 44 nxënës ka në një klasë), dhe kërkoi që të mos jetë numri i madh i nxënësve në një klasë, pasi që nuk mund t'i kushtohet as një minutë një nxënësi, por edhe arsimimi i tyre do të jetë i mangët.

Habib Mustafa- bëri të ditur që kjo Informatë është mjaft e thuktë, dhe kjo Informatë është mbi suksesin, e nuk është Informatë mbi gjendjen në arsim. Kërkoi që në të ardhmen në tabelën e tretë të dallohet (veqohet) gjimnazi prej shkollave teknike, pasi që shkolla e gjimnazit në testin kombëtar rangohet në rangun më të lartë në

Republikën e Kosovës. Ndërsa sa i përket suksesit në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët është i mirë, ndërsa arsimin e mesëm të lartë është i dobët. Në fund, për shkollat fillore paraqiti këto arsye të suksesit të kënaqshëm: furnizimi me tekste mësimore nga Qeveria e Kosovës, organizimi i transportit të rregullt për nxënësit (nga zonat rurale) nga shtëpia në shkollë dhe anasjelltas.

Sabit Kadriu- theksoi që në të kaluarën ka qenë traditë për çdo fillim legjislature, drejtorët e drejtorive të paraqesin raporte para këshilltarëve të Kuvendit, por tani një gjë e tillë nuk po ndodh. Kam pritur nga Drejtoria e Arsimit që në vend të kësaj Informate, të na paraqes një raport të detajuar, prandaj Lëvizja për Bashkim propozon që në mbledhjen e ardhshme ta kemi një raport të detajuar lidhur me: numrin e përgjithshëm të mësimdhënësve dhe të nxënësve të arsimit në Komunën tonë; numrin e shkollave fillore dhe të mesme; numri i nxënësve veçmas për secilin nivel të arsimit; numri i shkollave të ndërtuara dhe atyre që pritet të ndërtohen; gjendjen e kuadrit të përgjithshëm të shkollave të mesme (duke përfshirë gjendjen e laboratorëve, bibliotekave dhe sallave sportive); numrin e punëtorëve të arsimit që marrin paga të plota dhe të atyre që nuk marrin paga të plota, ndërsa punojnë me fondin e plotë të orëve; zbatimin ose moszbatimin e ligjshmërisë gjatë pranimit të kuadrit arsimor, sidomos të drejtorëve nëpër shkolla; suksesin e secilës shkollë veçmas, të arritur gjatë aplikimit të testit nacional.

Në fund propozoi që të organizohet një tribunë (konferencë), ku do të merrnin pjesë ekspertë të arsimit të të gjitha niveleve, dhe të debatojmë për të gjetur rrugën që të dalim nga kjo gjendje, sepse gjendjen (në arsim) nuk e kemi të mirë.

Esat Beka- propozoi që Drejtoria e Arsimit të nxjerr raportet e sukseseve nëpër të gjitha shkollat fillore, pasi që sukseksi në këto shkolla po del 96%, në mënyrë që të kuptohet se cilat shkolla po qesin cilësi të mirë, e cilat cilësi të keqe. Në fund, i rekomandoi Drejtorisë së Arsimit që të jetë e kujdesshme në zgjedhjen e drejtorëve të shkollave.

Besim Jashari- tha që duhet të jemi në nivelin e përgjegjësive që na takojnë. Në mandatin e kaluar është thënë që gjendja në arsim është alarmante, të njëjtat të dhëna i kemi edhe tani, por po shihet që jemi pajtuar me gjendjen alarmante në arsim. Përgjegjësia na takon të gjithëve, e në veçanti përgjegjësia iu takon atyre që e kanë marrë besimin për ta udhëhequr Komunën, gjegjësisht Drejtorinë e Arsimit. Në vazhdim theksoi që është shumë shqetësuese gjendja në arsim dhe se nuk po i kushtohet rëndësi e madhe përmirësimit të kësaj gjendjeje. Pastaj tha që nuk është në rregull që shkollat serbe të marrin (në të kaluarën) buxhet nga Komuna dhe të mos i raportojnë Drejtorisë së Arsimit. Në fund, paraqiti edhe shqetësimin për mungesat e nxënësve, duke thënë që në vitin e kaluar (niveli 10 -13) kanë qenë 58.000 mungesa, kurse tani janë 55.000 mungesa, dhe askujt kjo nuk i bën përshtypje.

Ferit Idrizi- tha që pa kaluar inspektorët e arsimit në kompetencë të Drejtorisë së Arsimit, vështirë do të ketë cilësi në arsim. Në vazhdim tha që inspektorët e arsimit duhet me i vizituar shkollat së paku dy herë brenda vitit, dhe me i identifikuar problemet, pastaj aty ku ka probleme duhet me u kthyer përsëri për ta vërtetuar se a është sanuar gjendja. Në fund tha që shpreson që përmes decentralizimit të bartjes së kompetencave të ketë inspektor (në kompetencë të Drejtorisë së Arsimit), pasi që sot Drejtoria e Arsimit nuk ka inspektor, sepse nuk ia lejon ligji.

Qerim Selimi- është kërkuar Informatë dhe kam paraqitur Informatë. Dhe tha se është i interesuar që në arsim të mos ketë po litikë, pasi që një gjë e tillë do të ishte e dëmshme për nxënësit. Në vazhdim tha që nëse krahasohen këto të dhëna (në Informatë) me vitin e kaluar, në ciklin e ulët dalin 4 klasë minus, gjegjësisht 133 nxënësja janë më pak, dhe kjo është brengosëse, pasi që është duke u zvogëluar numri i nxënësve në nivelin e parë. Nëse e krahasojmë suksesin e vitit të kaluar me suksesin e tanishëm, është pozitiv me 0.43 %, por prapë edhe ky sukses nuk është i kënaqshëm. Sukseksi i shkollave të mesme është i barabartë në gjysmëvjetorin e

parë, kurse në gjysmëvjetorin e dytë është rritur diferenca. Sa i përket institucioneve parashkollore, tha që nuk kemi asnjë punëtorë që mbanë mësim me ta në mënyrë legale, e këtë formë të funksionimit të tyre e kanë kërkuar prindërit e fëmijëve, duke angazhuar njerëz, të cilëve iu paguajnë nga 5 – 10 €. Poashtu bëri të ditur që mësimi për disa prej tyre zhvillohet në institucione shkollore, e disa jashtë institucioneve parashkollore, dhe tha që nuk ka hulumtuar se me çfarë programi punojnë, pasi që nuk është kompetentë për legalizimin e tyre. Mirëpo, bëri të ditur se me privatizimin e shërbimeve të mirëmbajtjes së shkollave, do të lirohen vende të mjaftueshme për marrjen e mësuesve me arsim parashkollor dhe në këtë mënyrë të inkuadrohen edhe parashkollorët në sistemin e arsimit, por kjo varet edhe nga përkrahja e delegatëve të Kuvendit dhe nga mundësitë buxhetore. Sa i përket kushteve në shkolla, janë më të mira se në vitin e kaluar, shkolla e mesme “Bahri Haxha” ka qenë ndër shkollat më të dobëta për nga infrastruktura, kurse tani është shkolla më e mirë në nivel vendi, por shkolla si e tillë nuk e ngritë cilësinë e mësimi, dhe shtoi se cilësinë e mësimi e ngrisin zbatimi i planprogrameve dhe zbatimi i ligjshmërisë. Ndërsa, sa i përket zgjedhjes së drejtorëve nëpër shkolla, tha që është kompetencë e Kryetarit të Komunës, duke u bazuar në propozimet e komisionit dhe tha që nuk e kemi ndërmend të bëjmë zgjedhje politike të drejtorëve të shkollave. Në fund tha që nëse e ka përkrahjen edhe nga delegatët e Kuvendit, gjendja në arsim do të përmirësohet.

Bajram Mulaku- bëri të ditur që premiset themelore për sukses në mësim në shkollat fillore dhe të mesme janë: krijimi i hapësirave shkollore (pra, kur në një shkollë zhvillohet vetëm një ndërrim), pajisjet me inventarë, laboratorët dhe pagesa e kënaqshme e punëtorëve të arsimit. Në vazhdim duke folur për suksesin e nxënësve, tha që duhet të bëhet dallimi në mes të shkollave të mesme, sepse gjimnazi ka treguar një sukses pozitiv dhe si i tillë duhet të çmohet, kurse dy shkollat e mesme teknike kanë treguar sukses tepër të dobët në provimin e pjekurisë në vitin e kaluar, prandaj drejtori i Drejtorisë së Arsimit duhet të përqendrohet në përmirësimin e cilësisë së arsimit. Në fund propozoi që me çdo kusht në fillimin e vitit të ri shkollor të hapet një paralele e parë e muzikës.

4. Propozimvendim për plotësimin e rregullorës për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale.

Ismet Gashi- tha që propozimvendimi është i bazuar në dispozita ligjore, por fomalo-juridikisht nuk është i hartuar siç duhet. Është dasht në titull ku figuron vetëm vendim, të jetë: vendimi për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale 01 Nr.742/08, të fillohet me nenin 1- me këtë vendim, neni 3, paragrafi 1 të Rregullores së lartcekur, i shtohet një pikë si në vijim: 3.1.20 - Çertifikata e shtetësisë 1 €, neni 3 tash bëhet neni 2, për zbatimin e këtij vendimi, propozuesi ka thënë kujdeset Drejtoria për Administratë, kurse unë propozoj të jetë: për zbatimin e këtij neni obligohet Drejtoria për Administratë. Në vazhdim e arsyei propozimin duke thënë se për mbikëqyrjen e zbatimit të vendimeve të kësaj Asambleje është i obliguar sipas nenit 58 të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës. Pastaj tha që neni 4 bëhet neni 3, ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit ashtu siç është.

Idriz Muzaqi- bëri të di tur se sa i përket vërejtjes për pikën e parë, me ligj nuk është e rregulluar forma se a duhet me qenë ky titull apo ai titull, se a do të jetë: vendimi mbi plotësimin e Rregullores, apo vendim dhe neni 1 – me këtë vendim plotësohet Rregullorja mbi taksat dhe tatimet, nuk ndërron asgjë. Kurse te vërejtja “kujdeset” apo “obligohet”, kjo kuptohet që është obligim, dhe si i tillë ky vendim nuk do të jetë një akt i veçantë, por i njëjti inkorporohet në Rregulloren mbi taksa dhe gjoba komunale, pra kemi të bëjmë me plotësim të Rregullores në fjalë, dhe në fund tha që rregulloret plotësohen apo ndryshohen me vendim.

**Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit me shumicë votash , lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:
*Aprovohet propozimvendimi për plotësimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoha komunale Nr. 742/08, datë 30.12.2008, me ndryshim të nenit 3 që në vend të fjalës “kujdeset” duhet të jetë “obligohet”.***

Në vazhdim pika nr. 5 dhe 6 u shqyrtuan së bashku.

5. Propozimvendimi për mënyrën e llogaritjes dhe lartësinë e kompensimit për mbikëqyrjen e objekteve – projekteve kapitale.

6. Propozimvendimi për mënyrën e llogaritjes dhe lartësinë e kompensimit për pranimin teknik të objekteve – projekteve kapitale .

Idriz Ismajli- paraqiti sqarimet hyrëse.

Sami Istrefi- theksoi që me kompensimin e komisioneve gjegjëse do të ketë më pak mundësi për keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe do të ketë më shumë cilësi në inspektimin e punëve. Në vazhdim të neni 4, propozoi që komisioni i pranimi teknik në rast se vlerëson se komisioni për mbikëqyrje të projektit nuk e ka kryer punën ashtu siç duhet, propozoi që vlera e kompensimit të jetë përgjysmë, ose 20 % në raport me vlerën që është e paraqitur në tabelë, ose t'i heqet krejt (kompensimi).

Zeqir Hasani- paraqiti disa vërejtje: së pari tha që duhet të cekën decidivisht përgjegjësitë që i ka ky komision dhe raportimet që do t'i bëjë. Pastaj, askund nuk është cekur që këto mjete që i merr si pagë shtesë, a do të tatimoren, pasi që me ligj obligohet si punë sekondare nga punëtorët e administratës për punët që kryhen; a do të merren neto apo bruto, dhe në çfarë forme do të bëhet shpërndarja e tyre, qoftë nga Komuna, qoftë nga investitori privat.

Veli Karaqa- tha që grupi asambleistë i LDK-së e mbështet propozimvendimin me qëllim të sigurimit të mbikëqyrjes së projekteve dhe ngritjes së cilësisë së punëve dhe përgjegjësisë së komisionit të pranimi teknik të projekteve. Në vazhdim të propozimvendimi mbi llogaritjen dhe kompensimin për mbikëqyrjen e objekteve-projekte kapitale, të neni 6, kur përmendet raportimi të Drejtoria për Administratë dhe Personel, propozoi të heqet krejt kjo drejtori, e le të mbetet vetëm Drejtoria për Prokurim dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, pasi që nuk është e nevojshme t'i raportohet Drejtorisë për Administratë dhe Personel.

Nysret Gërxhaliu- propozoi që pika 4.1, 4.2, 4.3 të harmonizohen dhe të precizohen në çfarë çmimi, e jo në çmim të parallogaritur, por në çmim të kontratës që nënshkruhet. Pastaj tha që si në vendimin e parë, ashtu edhe në të dytin që të mos përjashtohen ekspertët nga jashtë. Në fund tha që duhet të definohet që këta që bëjnë përcjelljen, nuk mund ta bëjnë edhe pranimin teknik, sepse është konflikt interesi.

Sabit Kadriu- u interesua që ta kuptoj se a duhet inspeksioni të merret me këtë problematikë, apo na duhet ta ngrisim ad hoc një komision të veçantë? Në vazhdim tha pasi që e kemi inspeksionin për mbarëvajtjen ose mosmbarëvajtjen e punëve duhet të jep përgjegjësi Drejtoria e Inspektoratit, kurse komisionet nuk e di sa mund t'i thërrasim për të dhënë përgjegjësi, pasi që komisionet krijohen për një moment. Në fund tha që këta 8 zyrtarë që janë paraparë për mbarëvajtjen e punëve në punishte, kjo duhet të jetë prej fillimit e deri në përfundim të një objekti.

Ismet Gashi- bëri të ditur që ka moskuptim të dallimit të mbikëqyrjeve dhe kompensimin e pranimi teknik të objekteve. Lidhur me propozimvendimi për llogaritjen dhe lartësinë e kompensimit për pranim teknik të objekteve, tha që bëhet fjalë për objektet private të cilat marrin leje në Drejtorinë e Urbanizmit dhe shumë mirë e ka cekur hartuesi në nenin 2 konform Ligjit për Ndërtimin, neni 51, dhe vendimit për caktimin e komisionit për pranim teknik, të lëshuar nga drejtoria

përkatëse që ka lëshuar lejen e ndërtimit. Në vazhdim theksoi që Drejtoria për Urbanizëm është e obliguar ta formoj komisionin për pranim teknik të objekteve që janë ndërtuar, e që është lëshuar leja, pasi që nuk ka të bëjë me objektet që ndërtohen pa leje dhe as të bëjë përcjelljen e objektit prej kur fillon e deri kur mbaron, pasi që për këtë çështje duhet komisioni që del për pranimin teknik, të kontrollojë librat e ndërtimit, të konsultohet me përfaqësuesin e inspeksionit, pastaj përpilohet raporti i cili i dorëzohet Drejtorisë së Urbanizmit dhe kjo drejtori ia lëshon lejen e përdorimit.

Idriz Muzaqi- tha që propozimvendimi për mbikëqyrjen e objekteve-projekteve kapitale, neni 4 flet për shpenzime fikse, kurse neni 5 thotë që shpenzimet për mbikëqyrje do të jenë pjesë e investimit (në paramasën dhe parallogaritë e punimeve), pra dalin në dokumentin e tenderit, e kur të dilet në dokumentin e tenderit, bjen nga fuqia neni 4, pasi që është e drejtë e ofertuesve që të ofertojnë me çmime të ndryshme sa i përket mbikëqyrjes. Në fund bëri të ditur që këto dy dispozita janë në kundërshtim me njëra-tjetrën, e përjashtojnë njëra-tjetrën, prandaj propozoi që të jetë vetëm neni 4, ose vetëm neni 5.

Muharrem Shabani- te llogaritja për mbikëqyrjen e objekteve-projekteve kapitale, kërkoi të bëhet një korigjim në paragrafin 1.1, ku thuhet investitor i të cilave është Kuvendi i Komunës, propozoi që të heqet termi “Kuvend” pasi që Komuna është subjekt juridik dhe jo Kuvendi. Poashtu kërkoi që të përcaktohen obligimet dhe përgjegjësitë e komisioneve përkatëse. Kurse sa i përket komisionit, propozoi që duhet të formohet një komision profesional.

Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit njëzëri, lidhur me pikën nr.5 të rendit të ditës vendosi me sa vijon:

Aprovohet propozimvendimi për mënyrën e llogaritjes dhe lartësinë e kompensimit për mbikëqyrjen e objekteve-projekteve kapitale, si në tekstin e propozuar dhe në bazë të disa vërejtjeve dhe propozimeve të paraqitura gjatë diskutimit.

Lidhur me pikën nr.6 të rendit të ditës Kuvendi me vota unanime aprovoi propozimvendimin për mënyrën e llogaritjes dhe lartësinë e kompensimit për pranimin teknik të objekteve-projekteve kapitale, sipas vërejtjeve dhe propozimeve me rastin e diskutimeve.

7. Propozimskema Organizative e Komunës për vitin 2010.

Sami Istrefi- propozoi që të formohen edhe 4 sektorë në Drejtorinë e Inspektoratit.

Besim Jashari- paraqiti vërejtje për formën e përpilimit të shkresave që po ia drejtojnë Kuvendit drejtoritë e Komunës, duke shtuar që në rastet kur drejtori t'i drejtohet Kuvendit përmes Kryetarit të Komunës. Kurse në rastin konkret tha që figuron emri i hartuesit, ndërsa në kreun e shkresës si propozues është Kryetari i Komunës, por nuk është e nënshkruar fare, që nënkuptohet se nuk ka kaluar përmes Kryetarit dhe nuk e ka parë fare, prandaj në këtë formë nuk është dasht të vjen fare në Kuvend.

Sabit Kadriu- propozoi që në kuadër të oragnogramit të përfshihet edhe Drejtoria e Bujqësisë. Poashtu propozoi që Zyra për të Drejtat e Njeriut të mos figuron në organogram, duke e arsyetuar që të drejtat e njeriut nuk janë problem komunal, institucional dhe shtetëror. Dhe në fund propozoi që të qitet në diskutim formimi i Drejtorisë për Bujqësi.

Muharrem Shabani- tha që propozimskema është dasht të harmonizohet me Statut, pasi që dy drejtori nuk i kanë emërtimet në përputhje me Statutin: Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, tha që duhet të jetë “Ambientit” në vend të “Mjedisit”; dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, duhet me qenë “Përkujdesje Sociale” në vend të “Mirëqenie Sociale”. Në fund, u pajtua me propozimin e S.Kadriut për formimin e Drejtorisë për Bujqësi.

Bajram Mulaku- bëri të ditur që për të krijuar drejtori të re, paraprakisht duhet bërë ndryshime në Statut. Kurse sa i përket propozimit për Drejtorinë e Inspektoratit, theksoi që në këtë drejtori funksionojnë 5 resorë: i tregut, ndërtimtarisë, ambientit dhe higjienës, komunikacionit, dhe sanitar.

Ferit Idrizi- tha që për formimin e drejtorive të reja duhet ndryshuar Statutin. Në vazhdim tha që emrat e drejtorive duhet shënuar në organogram në përputhje të plotë me Statutin, kurse te Drejtoria e Inspektoratit u dasht të futen në organogram edhe resorët e kësaj drejtorie.

Idriz Muzaqi- gjatë hartimit të Skemës kemi pasur parasyh dy parametra esencial: aspektin ligjor dhe planin buxhetor, i cili plan buxhetor është aprovuar nga Kuvendi për vitin vijues dhe çdo ndryshim që prodhon obligime buxhetore për këtë vit kalendarik, nuk mund të zbatohet. Në vazhdim duke iu referuar sugjerimit për Drejtorinë e Inspektoratit, shtoi se për këtë vit sipas planit buxhetor janë aprovuar nga Kuvendi koeficientët për çdo punëtor dhe propozimi i dy apo tre sektorëve nënkupton edhe gradime të punëtorëve, dhe ngritje të koeficienteve, gjë të cilën e kemi të pamundur për ta realizuar gjatë këtij viti.

Besim Jashari- pyeti nëse propozimi i Skemës organizative ka ardhur si pikë e rendit të ditës, e na duhet veç me votu, çfarë kuptimi ka diskutimi rreth saj? Në vazhdim tha që nëse do të ishte një afat i caktuar ligjor kur do të duhej paraqitur propozimi, dhe gjatë diskutimeve do të përfshiheshin edhe propozimet konkrete, për ta ndryshuar propozimin e dhënë, do të ishte e pranueshme, por nëse ka ardhur kështu siç është, duke mos pas mundësi për ndryshime për shkak që është ndarë buxheti, nuk ka kurrfarë kuptimi për të diskutuar për të.

Në vazhdim Kuvendi pas votimit, me 18 vota “për”, të tjerët “abstenim”, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:

Aprovohet Skema Organizative si në tekstin e propozuar. Emërtimi i dy drejtorive për të cilat u dha vërejtje gjatë diskutimit, të korrigjohen konform me Statutin e Komunës.

8. Kërkesa për bartjen e mjeteve të zotuarra dhe mjeteve të lira, nga THV të vitit 2008-2009 në vitin 2010.

Isuf Jashari- paraqiti sqarimet hyrëse.

Ismet Gashi- paraqiti vërejtje që propozuesi kërkon vendim prej Kuvendit për bartje të mejteve, kurse nuk ka sjellur projektvendim në formë të shkruar.

Zeqir Hasani- theksoi që nuk është praktikë e mirë që në fund të vitit buxhetor të ketë suficit, kur dihen nevojat e mëdha që kanë qytetarët e Komunës tonë. Në vazhdim tha që nuk mund të paraqitet kjo pasqyrë në formë tabelare dhe të aprovohet bartja e mjeteve, pa komente. Poashtu sa i përket pagave në shëndetësi, duke iu referuar arsytimit të I.Jasharit që një pjesë e tyre sipas marrëveshjes janë obligime për 44€, tha që nuk dihet a ka ndonjë pjesë tjetër të papaguar. Ndërsa, sa i përket komunalive, tabela 25, faqet 16,17,18,19, theksoi që ka shumë fatura të papaguara nga muaji i parë dhe te deri muaji i 11-të që e tejkalojnë shumën 5.000 €, por ka edhe shpenzime të derivateve, që gjithsej arrijnë shumën 50.645 € dhe që nuk janë paguar. Në fund tha që nuk ka kurrfarë arsytimi pse nuk janë paguar, pasi që furnitori për furnizim të derivateve është zgjedhë sipas procedurave të tenderit.

Në vazhdim Kuvendi pas votimit, me 17 vota “për”, të tjerët “abstenim”, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:

Lejohet bartja e mjeteve të zotuarra dhe të lira nga THV të vitit 2008 dhe 2009, në vitin 2010, siç është kërkuar nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

9. Propozimi i KPF-së për caktimin e lartësisë së kompensimit për komitetet konsultative.

Sami Istrefi- tha që të merret një vendim për kompensimin e anëtarëve të komiteteve konsultative, deri sa të bëhet rishikimi i buxhetit, dhe propozoi që të themelohet një rregullore e veçantë për funksionimin e komiteteve obligative dhe konsultative.

Në vazhdim Kuvendi pas votimit, me 20 vota “për”, 9 vota “kundër”, të tjerët “abstenim”, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon: *Aprovohet vendimi për caktim të lartësisë së kompensimit për komitetet konsultative në lartësinë prej 30 €, për çdo anëtar të Komitetit Konsultativ, për pjesëmarrje në mbledhje të komitetit. Anëtarët e komiteteve konsultative nuk do të kompensohen për më shumë se 6 mbledhje brenda 1 viti kalendarik.*

10. Të ndryshme

a. Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të dy zyrave të Shtëpisë së Kulturës në Prilluzhë;

Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit me shumicë votash , lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon: *Organizatës rinore “Duga” dhe asaj “Romano Anglinipe” dhe Radio-Stationit lokal “Mix Radio” të gjitha nga Prelluzha, iu ipen në shfrytëzim pa kompensim dy zyre në Qendrën e Kulturës në Prelluzhë, në afat prej 3 viteve, me mundësi vazhdimi, dhe njëkohësisht shfrytëzuesit e këtyre zyrave obligohen që t’i marrin përsipër shpenzimet komunale të rrymës, etj.*

b. Propozimvendimi për formimin e komisionit për intervistim, për drejtorë të shkollave;

Qerim Selimi- paraqiti sqarimet hyrëse.

Sabit Kadriu- tha që akoma nuk kemi njoguri se për cilat shkolla u shpallë konkurs, e për cilat nuk u shpallë, pastaj tha që diku janë emëruar kryerësit e detyrave të drejtorëve, e diku janë shkarkuar disa të tjerë pasi që është mbyllë konkursi. Sa i përket komisionit për prenimin e drejtorëve nëpër shkolla, tha që është dashur të përmenden se për cilat shkolla bëhet fjalë. Në vazhdim përmendi se në të kaluarën është praktikuar që në këtë komision të marrin pjesë nga një përfaqësues i grupeve asambliste dhe një përfaqësues i prindërve (të nxënësve). Ndërsa, tha që tani është kufizuar numri i këtij komisioni në tre anëtarë, të cilët do të jenë nga Komuna dhe do ta bëjnë politikën e Komunës.

Ferit Idrizi- tha që politizohet gjithçka dhe nuk zhvillohet demokracia nëse i dërgojmë përfaqësuesit e grupeve assembleiste në komisionin për përzgjedhjen e drejtorëve të shkollave.

Bajram Mulaku- tha që ky komision nuk zgjedhet vetëm për këtë konkurs, por zgjedhet deri në mandatin e ardhshëm, apo deri në ndonjë vendim tjetër që mund ta merr Kuvendi i Komunës. Në fund tha ligji e ka kufizuar numrin e anëtarëve të komisionit në fjalë.

Refik Ramaj- në emër të grupit sambleistë të LDK-së, propozoi për anëtar të komisionit Murteza Dallkun.

Sami Istrefi- duke iu referuar Udhëzimit Administrativ 3/2009, tha që Kuvendi ka të drejtë t'i propozoj dy anëtarë nga Komuna, kurse në emër të grupit samblistë të PDK-së propozoi për anëtar të komisionit Qerim Selimin.

Besim Jashari- bëri të ditur që në Udhëzimin Administrativ nuk thuhet që dy anëtarë të komisionit i cakton Drejtoria e Arsimit, por thuhet që caktohen nga Komuna, e Komuna nënkupton diçka më të gjerë se sa Drejtoria e Arsimit. Në fund tha që për shumë palë (prindërit, shoqërinë civile etj) është e rëndësishë së veçantë se kush e udhëheq një shkollë.

Sabit Kadriu- tha që nuk duhet të politizohet çështja e arsimit.

Ferit Idrizi- theksoi që ky Kuvend duhet ta formon këtë komision, në mënyrë që t'i ipet përgjegjësia Drejtorisë së Arsimit, dhe në rastet kur ka moskryerje të punëve nga ndonjë drejtor i shkollave, Kuvendi do të kërkon përgjegjësi nga Drejtoria e Arsimit.

Në vazhdim Kuvendi pas votimit, me 30 vota "për", një votë "kundër", një "abstenim", lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:
Anëtarë të komisionit për intervistim për drjetorë të institucioneve edukativo-arsimore caktohen: 1. Qerim Selimi, 2. Murteza Dallku, përfaqësues të Komunës, dhe një përfaqësues nga MASHT-i. Mandati i tyre zgjatë aq sa edhe mandati i tanishëm i anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Vushtrisë.

c. Propozimvendimi për formim të komisionit për hartimin e rregullores për përcaktimin e kriterëve të përfituesve material ndërtimor për ndërtim-meremetim të objekteve banesore.

Ismet Gashi- tha që rregulloren duhet ta harton Drejtoria e Shëndetësisë në bashkëpunim me ekzekutivin, gjegjësisht me drejtoritë tjera, kurse barrën kryesore e bart Drejtoria e Shëndetësisë, dhe pastaj rregullorja duhet të vjen për aprovim në Kuvend.

Safet Idrizi- pyeti pse i tërë ky hezitim, pse të mos formohet një komision prej tre anëtarëve për ta hartuar rregulloren?

Ferit Idrizi- tha që i mbetet Drejtorisë së Shëndetësisë që të na sjellë në Kuvend draftrregullore n në fjalë.

Në vazhdim të mbledhjes, Kuvendi pas votimit me shumicë votash, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës vendosi me sa vijon:
Obligohet Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale që të hartoi Draftregullore për përcaktimin e kriterëve të përfituesve të materialit ndërtimor për ndërtim dhe meremetim të objekteve të banimit për familjet skamnore. Kjo Draftregullore duhet të propozohet për shqyrtim në mbledhjen e radhës së Kuvendit.

Mbledhja përfundoi në orën 14:50.

Procesmbajtësi:
Albanez Tahiraj

Kryesuesi i Kuvendit
Ferit Idrizi